



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Fëmijëve



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201700596/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda: *Rekomandojmë marrjen e masave për përmirësimin e trajtimit, kushteve dhe mirërritjen e fëmijëve në Shtëpinë e Foshnjës 0-6 vjeç, Vlorë.*

Drejtuar: **Z. Dritan LELI**
Kryetar i Bashkisë Vlorë

Vlorë

Znj. Etleva BISHA
Shërbimi Social Shtetëror
Drejtoreshë e Përgjithshme

TIRANË

Të nderuar!

Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në zbatim të urdhrimit të Avokatit të Popullit nr. 51, datë 03.04.2017, kreu një inspektim të përgjithshëm në Shtëpinë e Foshnjës 0-6 Vlorë, më datë 08.05.2017.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrorë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënimet paraprake

Në përmbushje të detyrave kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të të drejtave njerëzore dhe lirive themelore të fëmijëve, si dhe në bazë të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet ndër të tjera se: "Avokati i Popullit ose persona të autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim apo autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në azile dhe veçanërisht në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër ku ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut".

“Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise”; Institucioni i Avokatit të Popullit sipas një plani vjetor inspektimesh ka kryer vizita monitoruese në Qendrat publike të përkujdesit të të miturve rezidencial në të gjithë vendin.

Objekti i inspektimit ishin trajtimi, kushtet dhe niveli i zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore të fëmijëve rezidentë në këtë institucion. Fillimisht grupi i ekspertëve kreu një takim paraprak me drejtuesen e institucionit, e cili u shpreh e gatshme për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit.

Gjatë muajit shkurt 2017, legjislacioni që mbulon këtë fushë shërbimesh ka ndryshuar me miratimin e Vendimeve nr. 106 dhe nr. 107, datë 15.02.2017, të Këshillit të Ministrave. VKM nr. 106, datë 15.02.2017 “Për një ndryshim në Vendimin Nr.425, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për Përcaktimin e Kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në Institucionet Rezidenciale, Publike dhe Jopublike, të Përkujdesjes Shoqërore”, të ndryshuar, riorganizon institucionet e përkujdesjes shoqërore publike, të cilave ju është lënë detyrë të transformojnë shërbimin brenda një periudhe 4-mujore nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ku për këtë institucion të inspektuar detyrimi i vendosjes së fëmijëve dhe periudhës së qëndrimit në këtë institucion është moshë 0-5 vjeç ku fëmijët marrin shërbime të përkujdesjes shoqëror rezidencial. Ndërsa VKM nr. 107, datë 15.02.2017, rrit kuotën mujore për fëmijët e grupmoshave 6-15 vjeç të cilët marrin një kuotë mujore 1.000 lekë dhe 16-18 vjeç 1500 lekë. Ndryshimet e kësaj VKM-je nuk preknin grupmoshën e fëmijëve të sistemuar në këtë institucion.

Trajtimi

Gjatë vizitës inspektuese u kqyrën kushtet materiale në të cilat jetojnë këto fëmijë, ambjentet e përbashkëta, dhomat e gjumit, tualetet, kuzhina, si dhe dokumentacioni i mbajtur nga stafi i institucionit në lidhje me aktivitetet që zhvillohen për këta fëmijë, kartelat mjekësore, dosjet psiko-sociale si dhe edukimi i tyre. Gjithashtu, gjatë inspektimit grupi inspektues u ndal veçanërisht në mbledhjen e të dhënave lidhur me trajtimin e tyre nga ana e stafit të këtij institucioni.

Aty trajtoheshin fëmijë të braktisur dhe nga familje me probleme ekonomiko-sociale të moshës 0-6 vjeç.

Gjatë inspektimit kishte gjithsej 14 fëmijë rezidencialë, ndërkohë që kapaciteti i qendrës ishte për 30 fëmijë. Nga gjithë fëmijët e sistemuar në institucion 3 fëmijë ishin jetim biologjik, 4 jetim social, 5 fëmijë me interesim dhe 6 pa interesim nga prindërit. Të gjithë fëmijët janë nga Vlora. Nga të dhënat e marra nga personeli i sektorit social vetëm një fëmijë ishte në proces birësimi i moshës 6 vjeç, 2 fëmijë ishin të peregjistruar në gjendjen civile gjë që sillte probleme për përfitimin e shërbimeve nga ana e tyre. Në këtë institucion kanë ardhur si rast emergjent 2 fëmijë të diagnostikuar me probleme të shëndetit mendor. Save the children ka mundësuar terapi 2 herë në javë nëpërmjet logopedit, megjithëse ky shërbim nuk ishte e plotësuar dhe e dokumentuar nga stafi psiko-socil te RVNE-të. Problematika kryesore ishte dokumentimi i të gjitha dosjeve të

fëmijëve. Si FID dhe RVNE-të, linin shumë për të dëshiruar në plotësimin e tyre, fakt i cili u pranua edhe nga përgjegjësjë e sektorit gjatë inspektimit të kryer nga ana jonë. Kujdestaritë e fëmijëve nuk ishin marrë nga Shtëpia e Fëmijës. Planet e largimit ishin inekzistente.

Gjatë inspektimit u vërejt se komunikimi i stafit me fëmijët, kalonte kufijtë e një komunikimi normal, verbal me fëmijë të vegjël, ku u vërejt një tonalitet i lartë zëri dhe paksa i ashpër në komunikimin me fëmijët. Një komunikim i tillë edhe pse ndoshta i paqëllimshëm nga ana e stafit është i papranueshëm për fëmijë të vegjël, të cilëve duhet tju komunikohet me qetësi e ëmbëlsi, duke shfaqur afeksion e dhembshuri. Etika e komunikimit në vendin e punës duhet të trajtohet me prioritet nga titullarja e institucionit, ku të merren masa për tërheqjen e vëmendjes ndaj stafit si dhe trajnimin e stafit në fushën e etikës së komunikimit me të mitur. Gjithashtu gjatë monitorimit u vërejt një fëmijë me gërvishje në faqe, i cili i pyetur nga ana jonë u përgjigj se ia kishte shkaktuar një fëmijë tjetër në institucion. Këto incidente nga ana e stafit jo vetëm që duhet të shënohen në fletoret e kalimit të turneve të kujdestareve por nga ana e stafit psiko-social duhet të merren masa për të punuar më tepër me fëmijët që shfaqin shenja agresiviteti ndaj fëmijëve të tjerë.

Punonjësi social dhe drejtuesi na komunikuan se mbanin kontakte të rregullta me familjarët por evidentimi i tyre në regjistrin përkatës linte për të dëshiruar. Rregjistri i interesimit nga prindrit ishte i paplotësuar në shumicën e rasteve. Dita e takimit të fëmijëve me prindërit ishte caktuar e mërkuara, por kishte fleksibilitet në këtë proces. Nga inspektimi rezultoi se dhoma e takimit me të afërmit ishte shndërruar në magazinë për vendosjen e biçikletave.

-Duke patur parasysh dhe numrin e lartë të fëmijëve me interesim pushteti vendor duhet të punojë më fort për fuqizimin ekonomikisht të familjeve që kanë fëmijët në këto institucione e që do të presin fëmijët. Interesi më i lartë i fëmijës është rritja e tij e kthimi në familjen biologjike, dhe jo transferimi nga institucioni në një tjetër institucion. Pra Bashkitë, e në këtë rast Bashkia Vlorë duhet të mundësojë punësimin e prindërve të këtyre fëmijëve për t'i fuqizuar ekonomikisht për mirërritjen e fëmijëve të tyre,

-Kuota ushqimore e fëmijëve 0-3 vjeç është 300 lekë; 3-6 vjeç është 310 lekë, e mbi 6 vjeç 330 lekë e cila konsiderohej e mjaftueshme.

Oraret e ngrënies ishin: mëngjesi 7.30-8.00; vakti i vogël 10.00-10.30; dreka 12.00-12.30; vakti i pasdites 16.00-16.30; darka 19.00-19.30. Përgatitej menuja javore, nga një grup punonjësesh të qendrës dhe afishohej. Dy menu, për fëmijët 0-2 vjeç dhe 3-6 vjeç. - Kampionët ushqimor ruheshin në kushte frigoriferike. Menuja javore ishte e afishuar dhe e firmosur nga P/Sektorit Social dhe magazinierja dhe miratohej nga Drejtoresha. Kampionët ushqimor mbaheshin në frigorifer. Ambientet ishin të pastra dhe librezat shëndetësore të stafit ishin në rregull.

Të drejtat e fëmijëve ishin të afishuara në muret e korridoreve në katin e parë të godinës.

Kutia e ankesave ndodhej në hyrje të Qendrës, me çelës dhe një ekip multidisiplinar me punonjës të DR të SHSSH Vlorë, e hapte një herë në muaj.

Personeli dhe Organika

Ky Institucion ka varësi të dyfishtë: nga Bashkia Vlorë, e cila emëron stafin dhe nga Shërbimi Social Shtetëror i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, që akordon fonde nga buxheti i shtetit.

Personeli përbëhej nga 20 veta të punësuar nga SHSSH, dhe 8 veta nga Bashkia Vlorë. Pra afro 70% e buxhetit nga SHSSH dhe 30% nga Bashkia e Vlorës. Struktura përfshin dy sektorë: sektorin e Administratës (përgjegjës, 2 kuzhinierë, 1 punëtor mirëmbajtjeje dhe 2 pastrues) dhe Sektorin e Shërbimit Social (përgjegjësi-punonjësi social, 1 edukator dhe 11-kujdestare).

Për më tepër, Organika e miratuar me Urdhër të Kryeministrit, për institucionin e mësipërm rezidencial nuk është në përputhje me paketën e Standardeve dhe Procedurave për institucionet rezidenciale publike dhe jo-publike që shërben si udhëzues për të gjithë mënyrën e funksionimit dhe vlerësimit të punës së qendrave, ku edhe përcaktohen qartësisht specialitetet dhe standardi punonjës për numër fëmijësh. Sipas paketës së standardeve për këtë institucion, duhet të kishte:

1-10 fëmijë-1 punonjës social

1-20 fëmijë-1 pediatër

1-20 fëmijë-1 psikolog

1-5 fëmijë- 1 edukator

1-10 fëmijë- 1 infermier

1-5 fëmijë- 1 kujdestar

Personeli kujdestar dhe edukator ishin kryesisht me arsim të mesëm. Drejtuesja në bashkëpunim me specialistët hartonte planet edukative të zhvillimit; hartonte planet e punës së çdo sektori. Dosjet e personelit gjenden në institucion (kopje e tyre); ndërkohë që dosjet origjinale ndodheshin pranë Bashkisë Vlorë. Drejtuesja e kësaj qendre është e diplomuar në Psikologji.

Nga 8 punonjësit e rekrutuar e të paguar me fondet e Bashkisë Vlorë ishin: 1 kushiniere, 1 sanitare, 1 sociologe dhe 5 kujdestare.

Puna ishte e organizuar me tre turne. Çdo turn ka dy kujdestare në katin e 2 dhe dy kujdestare në katin e 3 të godinës.

Institucioni nuk ka psikolog, megjithëse nga punonjësit e kontaktuar na u konfirmua se kërkesat përkatëse i janë drejtuar Bashkisë së Vlorës.

Po ashtu nuk ka roje.

U konstatua mungesë mjeku e infermieri. Organika e këtij institucioni për sektorin e kujdesit shëndetësor ishte e paplotësuar me mjek dhe ndihmës mjek, por nevojat e kësaj qendre mbuloheshin në raste urgjence nga Spitali Pediatrik e Spitali Rajonal i Vlorës, ndërsa detyrën e ndihmësmjekes e kryente një kujdestare e këtij institucioni, e cila ishte e diplomuar për infermieri. Dy nga fëmijët ishin me probleme të shëndetit mendor:

- Nga komunikimi me drejtoreshën u theksua fakti i nevojave për trajnim të stafit, pasi edhe për këtë vit stafi nuk kishte marrë asnjë lloj trajnimi përveç atij të ndihmës së shpejtë të ofruar nga Kryqi i Kuq Shqiptar.

Kushtet materiale

Godina ishte tre katëshe: Të gjitha katet në anën e djathtë të tyre kishin një lagështirë të theksuar shumë e dëmshme për shëndetin dhe mirëritjen e fëmijëve. Në

katin e parë ishin Zyra e drejtueses, financa, zyra sociale, mensa, kuzhina, dhoma e takimit me prindët, lavanteria, magazina dhe pjesa e detergjentëve.

Kati 2-Dhoma e personelit; dhoma e TV, 2 dhoma gjumi për djemtë; 1 dhomë për vajzat; klasa e pikturës, vizatimit, dhomë lodrash dhe tualeti. Kati 3-Dhoma e bebeve, 2 dhoma gjumi (për më të rriturit); klasa ku luajnë të vegjlit; dhoma e prindërve; 2 dhoma lojrash; infermiera dhe tualeti.

-Instalimet elektrike ishin të dala mbi muret e kësaj godine. Drejtoresha dhe sftafi na pohoi se nuk kishte problem për fëmijët gjendja e kablove në këtë formë.

- Shkallë emergjence ky institucion nuk ka.

- Kushtet e strehimit dhe furnizimi me artikuj të dhomave të gjumit, të gatimit, etj ishin në parametra normale. Artikulli “veshje” ose ai me numër 602 mbulohej nga Bashkia e Vlorës.

-Ngrohja dhe ftohja e ambienteve kryhej me kondicionerë.

-Nevoja e vendosjes së tendave për diellin në dritaret e katit të 2 dhe të 3 për stinën e nxehtë të verës.

-Pajisjet kundra rrezikut të zjarrit ishin të vendosura në çdo kat, por bombulat kundër zjarrit nuk ishin të koaliduara dhe punonjësit nuk ishin të trajnuar nga shërbimi i zjarrëfikseve dhe për rastet e emergjencave.

Lavanteria ndodhej në katin e parë të godinës, ku u gjetën në gjendje pune tre lavatrice dhe asnjë tharëse rrobash.

Problem i konstatuar ishte mungesa e automjetit. Nga drejtuesja e institucionit përdorej makina personale për transport fëmijësh në raste emergjence apo urgjence.

Gjatë inspektimit por edhe nga biseda me drejtuesen e institucionit na u komunikua se janë bërë disa rregullime të vogla si dhe lyerje e disa ambienteve dhe pritej një rikonstruksion i disa ambienteve të kësaj godine nga një fondacion gjerman.

Edukimi dhe aktivitetet

-Mungesa e një automjeti kufizon edhe lëvizjet për argëtimin e fëmijëve. Po ashtu edhe oborri i jashtëm ka nevojë për investime me qëllim argëtimin me lojra të fëmijëve. Në oborrin mbrapa godinës ishin shtuar disa lodra të cilat pasuronin disi këndin e lodrave të institucionit.

Fëmijët e moshës 3-6 vjec frekuentonin kopështin e lagjes 2-3 herë në javë. Në institucion fëmijët kryenin aktivitete të ndryshme si lojra të ndryshme te këndi i lojrave, ngjyrosje, dalje me bicikletë. Një herë në javë shkonin te këndi i lojrave të qytetit. Gjatë verës në institucion vjen një grup vullnetarësh nga Italia të cilët për një muaj rresht shoqërojnë fëmijët në plazh, në Zvërnec, nën mbikëqyrjen e stafit të institucionit, në kuadër të një marrëveshje të nënshkruar midis palëve. Ditëlindjet e fëmijëve festohen gjithmonë të ndihmuar edhe nga donatorë të ndryshëm.

Në mënyrë që Shtëpia e Fëmijës Vlorë si institucion i përkujdesit publik rezidencial për fëmijët, të plotësojë standardet e shërbimit të përkujdesit shoqëror në Institucionet Rezidenciale,

REKOMANDOJMË

1-Marrjen e masave të menjëhershme për tërheqjen e vëmendjes stafit që punon direkt me fëmijët, për një komunikim sa më etik e profesional me fëmijët e këtyre grupmohave si dhe trajnimin e stafit mbi etikën e komunikimit në punë si dhe për parandalimin e çdo forme dhune ndaj fëmijëve..

2- Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin sic duhet të FID-it dhe RVNE-ve.

3- Marrjen e masave të menjëhershme që për cdo plan largimi të fëmijëve nga institucioni, këto plane të plotësohen në kohën dhe mënyrën e duhur.

4- Marrjen e masave për plotësimin korrekt të librit të interesimit të familjarëve për fëmijët.

5-Marrjen e masave për plotësimin e mungesave në burimet njerëzore të stafit si psikologu, mjeku e roja.

6- Marrjen e masave për indeksimin e kuotës financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve të fëmijëve përfitues nga ky institucion.

7- Marrjen e masave për vendosjen e një automjeti për transportin e këtyre fëmijëve.

8- Marrjen e masave për vendosjen e shkallëve të daljes për raste emergjencash duke përmbushur standardet e rregullores kundër rreziqeve nga zjarri.

9- Marrjen e masave për rikonstruksionin e ambienteve të të tre kateve të godinës të cilat kanë lagështirë si dhe marrjen e masave për kryerjen e instalimeve të reja elektrike, sepse rrjeti elektrik rezultonte tejte i amortizuar.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”.

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe në vijimësinë e bashkëpunimit në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve.

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI